



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosovo - Republic of Kosovo*  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
*Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority*



## **Analiza e tregut të çimentos në Kosovë**

### **Periudha 2022-2023**



## PERMBAJTJA

<b>LISTA E GRAFIKONEVE</b>	<b>4</b>
<b>I. Analiza e tregut të çimentos në Kosovë</b>	<b>5</b>
1) Përmbledhja e analizës së tregut të çimentos në Kosovë për periudhën 2022-2023	5
2) Historiku i ndërmarrjes prodhuese SharrCem SHPK	6
a. Prodhimet e çimentos nga Ndërmarrja SharrCem ShPK	6
b. <b>Importi i Çimentos në Kosovë, përqindja e disa ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim të ndjeshme në import, për periudhën 2022-2023</b>	<b>7</b>
c. Prodhimi vendor i çimentos dhe importet për vitet 2022-20223	9
<b>II. STRUKTURA E TËRËSISHME E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2022 DHE 2023</b>	<b>11</b>
d. Pjesëmarrja e (X) Group në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2022	14
e. Pjesëmarrja e (X) në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2023	15
f. <b>Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitet 2022-2023</b>	<b>16</b>
3) Çmimi mesatar i shitjes	23
4) Çmimi mesatar i blerjes sipas muajve	30
<b>III. Konkluzion</b>	<b>33</b>

## LISTA E TABELAVE

Tabela Nr 1. Importi i çimentos për vitin 2022 _____	7
Tabela Nr. 2. Importi i çimentos për vitin 2023 _____	8
<i>Tabela Nr. 3. Struktura e tregut të çimentos-2022 _____</i>	11
Tabela Nr. 4. Qarkullimi vjetor në miliona Euro _____	13
Tabela Nr. 5. Pjesëmarrja në treg e (X) të çimentos, që furnizojnë tregun-2022 _____	14
Tabela Nr. 6. Pjesëmarrja në treg e (X) të çimentos, që furnizojnë tregun-20223 _____	15
Tabela Nr. 7. Importi sipas shteteve-2022 _____	16
Tabela Nr. 8. Importi sipas shteteve-2022 _____	17
<i>Tabela Nr. 9. Çmimi mesatar i furnizimit/sipas shteteve-2022 _____</i>	18
Tabela Nr. 10. Çmimi mesatar i furnizimit/sipas shteteve-2022 _____	18
Tabela Nr. 11. Përqindja e pjesëmarrjes se Klinkerit në sasinë totale të çimentos-2022 _____	19
Tabela Nr. 12. Përqindja e pjesëmarrjes se Klinkerit në sasinë totale të çimentos-2022 _____	19
<i>Tabela Nr. 13. Çmimi mesatar i shitjes pa TVSH për çimenton e importuar-2022 _____</i>	23
Tabela Nr. 14. Çmimi mesatar i shitjes se çimentos se importuar-2023 _____	24
Tabela Nr. 15. Çmimi i shtijës se çimentos se (X) në Kosovë _____	26
Tabela 16. Krahasimi çmimeve mes çimentos se (X) dhe asaj të importuar _____	27
Tabela 17. Krahasimi çmimeve mes çimentos se (X) dhe asaj të importuar-2023 _____	29
Tabela 18. Çmimi mesatar i furnizimit-2022 _____	30
Tabela 19. Çmimi mesatar i furnizimit-2023 _____	31

## LISTA E GRAFIKONEVE

Grafiku Nr.1. Importi i çimentos për vitin 2022	8
Grafiku Nr. 2. Importi i çimentos për vitin 2023	9
<i>Grafiku Nr. 3. Krahasimi (X) – (X) vendor për vitin 2022</i>	10
Grafiku Nr. 4. Krahasimi (X) – (X) vendor për vitin 2023	10
Grafiku Nr. 5. Struktura e tregut të çimentos për vitin 2022	11
<i>Grafiku Nr. 6. Struktura e tregut të çimentos për vitin 2023</i>	12
Grafiku Nr. 7. Qarkullimi vjetor në miliona Euro-2022	13
<i>Grafiku Nr. 8. Qarkullimi vjetor në miliona Euro-2023</i>	14
Grafiku Nr. 9 Pjesëmarrja në treg e (X) të çimentos, që furnizojnë tregun-2022	15
<i>Grafiku Nr. 10. Pjesëmarrja në treg e (X) të çimentos, që furnizojnë tregun-2023</i>	16
Grafiku Nr. 11. Struktura e importit sipas shteteve-2022	18
Grafiku Nr. 12. Çmimi mesatar i shitjes për çimenton e importuar-2022	24
Grafiku Nr. 13. Çmimi mesatar pa TVSH-2023	25
Grafiku Nr. 14. Çmimi mesatar i shitjes se çimentos se (X) -2022	26
Grafiku Nr. 15. Çmimi mesatar i shitjes se çimentos se (X) -2023	27
Grafiku Nr. 16. Krahasimi i çmimit të shitjes mes çimentos se (X) dhe asaj të (X)	28
Grafiku Nr. 17. Krahasimi i çmimit të shitjes mes çimentos se (X) në Kosovë dhe asaj të (X)-2023	29
Grafiku Nr. 18. Çmimi mesatar i shitjes sipas muajve-2022	31
Grafiku Nr. 19. Çmimi mesatar i shitjes sipas muajve-2022	32

## I. Analiza e tregut të çimentos në Kosovë

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, neni 26 paragrafi 2, neni 39 paragrafi 1, si dhe neni 64 paragrafi 3, ka filluar mbledhjen e të dhënave për tregun e çimentos në Kosovë.

Për ta analizuar tregun e çimentos në Kosovë Autoriteti i Konkurrencës ka mbledhur dhe përpunuar të dhënat e ofruara nga institucione dhe ndërmarrje të ndryshme:

1. Dogana e Kosovës
2. Ndërmarrja (X)
3. Ndërmarrja (X)
4. Ndërmarrja (X)
5. Ndërmarrja (X)
6. Ndërmarrja (X)

### 1) Përmbledhja e analizës së tregut të çimentos në Kosovë për periudhën 2022-2023

Autoriteti i Konkurrencës në këtë analizë të tregut të çimentos në Kosovë paraqet: strukturën e tregut, pjesëmarrësit në tregun përkatës, sjelljen e tyre, përparësitë ose dobësitë, nivelin e konkurrencës në këtë treg. Gjithashtu në këtë analizë paraqitet prodhimi vendor të çimentos, importin e ndërmarrjeve kryesore që afrojnë në këtë treg, pjesëmarrjen e tyre në tregun e Kosovës, krahasimin e çmimeve me tregjet rajonale (Shqipëri, Maqedoni e Veriut në raport me prodhimin vendor), për periudhën 2022-2023.

Kjo analizë e tregut do të publikohet në web faqen e ARKK-së duke u bazuar në nenin 51 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

## 2) Historiku i ndërmarrjes prodhuese SharrCem SHPK

Në fillim të vitit 2010 Titan Group kishte marrë përsipër operimin e fabrikës së çimentos “Sharr” në atë kohë ishte në pronësi dhe pjesë e Ndërmarrjes Shoqërore “Sharr” (**Fabrika e Çimentos**), pas blerjes së **Sharr Beteiligungs GmbH**, një kompani gjermane, e cila operonte Fabrikën e Çimentos si qiramarrës në bazë të një marrëveshje të qirasë të lidhur në qershor 2000 dhe të paraparë për të qenë në fuqi deri më 31 dhjetor 2010 (“**Marrëveshja e Qirasë**”).

Në fund të vitit 2010 pasuritë/asetet e Fabrikës së Çimentos u transferuan në një kompani të themeluar rishtas, “Ndërmarrja e Re SharrCem ShP.K” aksionet e së cilës ishin ofruar për shitje në procesin e privatizimit. Pas fillimit të procesit të privatizimit, Sharr Beteiligungs GmbH ushtroi të drejtat e veta të parablerjes sipas Marrëveshjes së Qirasë, sipas së cilës qiramarrësi gëzonte *të drejtën e refuzimit (ofertimit) të parë* në rast se Fabrika e Çimentos ofrohej për shitje. Pas përfundimit të procedurës së privatizimit, më 9 dhjetor 2010 Sharr Beteiligungs GmbH bleu/fitoi 100% të aksioneve të “Ndërmarrja e Re SharrCem” ShPK” që më pas u riemërua **ndërmarrja SharrCem ShPK**.

### *a. Prodhimet e çimentos nga Ndërmarrja SharrCem ShPK*

Prodhimet e ngjashme të çimentos janë përdorur për ndërtimet greke dhe ato romake para më shumë se 2000 vjet, megjithatë çimentoja bashkëkohore për herë të parë ishte prodhuar në gjysmën e parë të shekullit nëntëmbëdhjetë.

Çimentoja është lëndë e parë që përdoret për prodhimin e betonit si edhe të prodhimeve të tjera ndërtimore të cilat kanë dedikim të ndryshëm. Çimentoja, si material pluhur lidhëse është pjesë e grupit të agjendave joorganike hidraulike lidhëse.

Agjentët hidraulike lidhëse bëhen të forta në praninë të ujit prej të cilit fitohen prodhime të kristalizuara të cilat nuk shkrihen në ujë. Për shkak se agjentet hidraulike lidhëse bëhen të forta në ujë, d.m.th. nuk ndryshohen në ekspozimin permanent të ujit.

Çimentoja është një nga materialet më të rëndësishme dhe më të shfrytëzuara në ndërtimtari. Para se të forcohet fort lidhet me mineralët dhe agregatet e tjera, çelik, tulla, me çfarë mundësohet përdorimi i gjerë në dizajnin e ndërtimeve nga betoni i zakonshëm, betoni i forcuar dhe betoni i

parashtrënguar, muret e tullave dhe gurëve natyror, si edhe në dizajnin e mbështjelljeve të brendshme dhe të jashtme prej llaçit etj.

Fabrika e prodhimit të çimentos SharrCem ShPK momentalisht prodhon tri lloje të çimentos Portland, lidhës hidraulik, dhe Usjemall:

- CEM II/A-V 42,5 R\*), MKS; CEM II/B-M (V-L) 42,5 N
- CEM II/B-M (V-L) 42,5 N, MKS; CEM II/A-V 42,5 R
- CEM I 42,5 R MKS; CEM I 42,5 R
- Usjemall (lidhësi hidraulik \*) 45S – një klasë çimentoje me rezistencë të zakonshme në shtypje të hershme (në 3 ditë) të treguar nga C.

Çimentoja e përhimt “Portland” është material lidhës e cila përdoret në të gjitha sferat të ndërtimtarisë për ndërtimin e shtëpive, banesave, shkollave, spitaleve, tuneleve dhe aeroporteve.


Çimentoja e përhimt “Portland” është lloj i çimentos që bëhet nga klinkeri i bluar, gips dhe pozollanë natyrore (*lënda e parë që fitohet nga shkëmbat vullkanik*) dhe hiri i qymyrit. Klientët i përdorin këto lloje të çimentos për çdo punë ndërtimore, megjithatë, përdorimi kryesor e kanë për projektet ndërtimore të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm me ujë ose të cilat ndërtohen në tokë të lagët.

*b. Importi i Çimentos në Kosovë, përqindja e disa ndërmarrjeve të cilat kanë ndikim të ndjeshme në import, për periudhën 2022-2023*

<b>IMPORTI I ÇIMENTOS PËR VITIN 2022</b>			
<b>Nr</b>	<b>Ndërmarrja</b>	<b>Pesha neto në TONË</b>	<b>Përqindja</b>
1	X	X	14.67%
2	X	X	12.78%
3	X	X	12.04%
4	X	X	12.00%
5	X	X	7.68%
6	Përafërsisht 68 ndërmarrje tjera	266,710.73	40.82%
	<b>Total</b>	<b>653,303.63</b>	<b>100.00%</b>

*Tabela Nr 1. Importi i çimentos për vitin 2022*

Në tabelën Nr. 1, paraqesim Importin e çimentos për vitin 2022 i cili ishte 653,303.63 tonë. Ndërmarrja (X) në importin e përgjithshëm kishte pjesëmarrje prej 14.67%, (X) prej 12.78%, (X) prej 12.00 %, (X) rreth 12.04%, (X) prej 7.68%, ndërsa 68 ndërmarrje tjera prej 40.82%.




Grafiku Nr.1. Importi i çimentos për vitin 2022

<b>IMPORTI I ÇIMENTOS PËR VITIN 2023</b>			
Nr.	Ndërmarrja	Pesha neto në TONË	Përqindja
1	X	X	45.20%
2	X	X	29.29%
3	X	X	8.91%
4	Përafërsisht 48 ndërmarrje tjera	X	16.61%
	<b>Total</b>	<b>757,916.86</b>	<b>100.00%</b>

Tabela Nr. 2. Importi i çimentos për vitin 2023



Në tabelën Nr. 2, paraqesim Importin e çimentos për vitin 2023 i cili ishte 757,916.86 tonë. Ndërmarrja (X) në importin e përgjithshëm kishte pjesëmarrjeje prej 45.20 %, (X) prej 29.29%, (X) prej 8.91 %, ndërsa 48 ndërmarrje tjera prej 16.61%.



Grafiku Nr. 2. Importi i çimentos për vitin 2023

*c. Prodhim vendor i çimentos dhe importet për vitet 2022-2023*

Prodhim Vendor i Çimentos dhe Importet e paraqitur në tonë për vitet 2022-2023					
Nr.	Ndërmarrja	2022	%	2023	%
1	X	631,486.00	49.15%	758,930.00	50.03%
2	X	653,303.63	50.85%	757,916.86	49.97%
	<b>Gjithsejtë</b>	<b>1,284,789.63</b>	<b>100</b>	<b>1,516,846.86</b>	<b>100</b>


Tabela Nr.3. Krahasimi i prodhimit vendor dhe importit 2022-2023

### Importi dhe Prodhimi vendor-Krahasimi 2022



Grafiku Nr. 3. Krahasimi import-prodhim vendor për vitin 2022

### Importi dhe Prodhimi vendor-Krahasimi 2023



Grafiku Nr. 4. Krahasimi import-prodhim vendor për vitin 2023

Në tabelën Nr. 3 është krahasuar prodhimi vendor dhe importet për periudhën 2022-2023:

- Për vitin 2022 nga (X) i çimentos plotësoheshin nevojat prej 49.15% të tregut, kurse nga (X) prej 50.85 %.
- Për vitin 2023 (X) prej 50.03 %, (X) prej 49.97%.

Kur analizojmë vitet 2022-2023 vërehet se në vitin 2023 (X) kishte qenë më i lartë se sa (X), (X) kishte mbuluar nevojat e tregut rreth **50.03 %**.


## II. STRUKTURA E TËRËSISHME E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2022 DHE 2023

Ndërsa, analizuar tërësinë e çimentos që kanë shitur ndërmarrjet (duke përfshirë edhe importin por edhe prodhimin), struktura e ndërmarrjeve sipas viteve është si vijon:

STRUKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2022				
Nr	Ndërmarrja	Adresa	Pesha neto në TONË	Përqindja
1	X	X	727,338.24	56.61%
2	X	X	83,491.43	6.50%
3	X	X	78,390.55	6.10%
4	X	X	78,667.48	6.12%
5	X	X	50,191.20	3.91%
6	Përafërsisht 68 ndërmarrje tjera		266,710.73	20.76%
	Total		1,284,789.63	100.00%

Tabela Nr. 3. Struktura e tregut të çimentos-2022

Nga tabela nr. 3, ndërmarrja (X) , ka pjesëmarrje në tregun e përgjithshëm prej 56.61 %.



Grafiku Nr. 5. Struktura e tregut të çimentos për vitin 2022


### STURKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2023

Nr	Ndërmarrja	Adresa	Pesha neto në TONË	Përqindja
1	X	X	1,101,230.63	72.60%
2	X	X	221,967.93	14.63%
3	X	X	67,759.29	4.47%
4	Përafërsisht 48 ndërmarrje tjera		125,889.01	8.30%
	Total		1,516,846.86	100.00%

Tabela Nr. 4. Struktura e tregut të çimentos-2022

Nga tabela nr. 4, ndërmarrja (X) , ka pjesëmarrje në tregun e përgjithshëm prej 72.60 %.

### STURKTURA E TREGUT TË ÇIMENTOS PËR VITIN 2023



Grafiku Nr. 6. Struktura e tregut të çimentos për vitin 2023


Qarkullimi vjetor i paraqitur në miliona euro të (X) dhe 4 (X) me % më të madhe në importe prej vitet 2022-2023

Nr.	Ndërmarrja	2022	%	2023	%
1	X	X	66.60%	X	64.56%
2	X	X	6.57%	X	14.06%
3	X	X	12.98%	X	12.25%
4	X	X	6.76%	X	4.76%
5	X	X	7.09%	X	4.38%
Total		113.947	100	166.235	100

Tabela Nr. 4. Qarkullimi vjetor në miliona Euro

Në tabelën Nr. 4 paraqitet qarkullimit vjetor i ndërmarrjeve importuese dhe prodhues për vitin 2022, ndërmarrja (X) kishte 66.60 %, të tregut, ndërmarrjet importuese: (X) 7.097%, (X) 13.57% ndërmarrja (X) 7.70% dhe (X) kishte 7.16%

Ndërsa qarkullimi vjetor i ndërmarrjeve importuese dhe prodhues për vitin 2023 ishte: ndërmarrja (X) kishte 64.56 %, të tregut, ndërmarrjet (X) 14.06%, ndërmarrja (X) kishte 12.25% (X) 4.76% dhe (X) 4.38%



Grafiku Nr. 7. Qarkullimi vjetor në miliona Euro-2022



Grafiku Nr. 8. Qarkullimi vjetor në miliona Euro-2023


*d. Pjesëmarrja e (X) Group në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2022*

Emrat e ndërmarrjeve prodhuese/eksportuese vendi i origjinës	Importi/prodhimi në tonë	Gjithsejtë	%
X	631,486.00	1,018,105.94	79.24
X	100,572.00		
X	282,636.86		
X	3,411.08		
X	85,597.20	85,597.20	6.66
X	78,418.01	78,418.01	6.10
X	76,248.72	76,248.72	5.93
Importet nga fabrikat tjera	26,419.76	26,419.76	2.06
<b>Gjithsejtë importi dhe prodhimi vendor</b>	<b>1,284,789.63</b>	<b>1,284,789.63</b>	<b>100</b>

Tabela Nr. 5. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të çimentos, që furnizojnë tregun-2022

Në tabelën Nr. 5, është paraqitur pjesëmarrja e (X) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga ndërmarrjet e tjera për vitin 2022. Nga kjo analizë vërehet se (X) së bashku me ndërmarrjen e çimentos në Kosovë (X), pastaj njësia në Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Greqi, kishte mbuluar nevojat e

tregut të çimentos në Kosovës prej 79.24%, (X) 6.66%, (X) SHPK, Shqipëri merr prej 6.10%, (X) 5.93%, ndërsa nga ndërmarrjet tjera të rajonit prej 2.06%.




Grafiku Nr. 9 Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të çimentos, që furnizojnë tregun-2022

*e. Pjesëmarrja e (X) në Kosovë dhe eksportuesit tjerë për vitin 2023*

Emrat e kompanive prodhuese/eksportuese vendi i originës	Importi/prodhimi në tonë	Gjithsejtë	%
X	758,930.00	1,101,479.70	72.62%
X	56,865.84		
X	280,444.40		
X	5,239.46		
X	221,967.93	221,967.93	14.63%
X	79,458.03	79,458.03	5.24%
X	74,127.46	74,127.46	4.89%
Importet nga fabrikat tjera	39,813.74	39,813.74	2.62%
<b>Gjithsejtë importi dhe prodhimi vendor</b>	<b>1,516,846.86</b>	<b>1,516,846.86</b>	<b>100</b>

Tabela Nr. 6. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të çimentos, që furnizojnë tregun-20223

Nga tabela Nr. 6, është paraqitur pjesëmarrja e (X) në Kosovë, si dhe eksportuesit nga ndërmarrjet e tjera për vitin 2023. Nga kjo analizë (X) së bashku me (X) e çimentos në Kosovë (X) , Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Greqi, kishte mbuluar nevojat e tregut të çimentos në Kosovës prej 72.62%, Ndërmarrja (X), merr pjesë prej 14.63 % Ndërmarrja (X) merr pjesë me 5.24 %, (X) merr pjesë me 4.89 %, ndërsa nga fabr e tjera prej 2.62%.



Grafiku Nr. 10. Pjesëmarrja në treg e prodhuesve të çimentos, që furnizojnë tregun-2023

*f. Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitet 2022-2023*

Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2022			
Nr.	Vendi	Pesha Neto-ton	%
1	Shqipëria	381,583.34	58.41%
2	Maqedonia e veriut	248,726.12	38.07%
3	Greqia	8,773.04	1.34%
4	Vendet tjera	14,221.13	2.18%
<b>Gjithsejtë</b>		<b>653,303.63</b>	<b>653,303.63</b>

Tabela Nr. 7. Importi sipas shteteve-2022




Në tabelën Nr. 7, është paraqitur pjesëmarrja e importit të çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2022. 58.41% ishte importuar nga Shqipëria, 38.07% nga Maqedonia e Veriut, nga Greqia 1.34% si dhe nga vendet tjera 2.18%.

Importi i Çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2023			
Nr.	Vendi	Pesha Neto	%
1	Shqipëria	441,993.71	58.32%
2	Maqedonia e veriut	280,444.42	37.00%
3	Bullgaria	30,120.11	3.97%
4	Vendet tjera	5,358.64	0.71%
<b>Gjithsejtë</b>		<b>757,916.89</b>	<b>100</b>


Tabela Nr. 8. Importi sipas shteteve-2022

Në tabelën Nr. 8, është paraqitur pjesëmarrja e importit të çimentos nga vendet e rajonit për vitin 2023. 58.32% ishte importuar nga Shqipëria, nga Maqedonia e Veriut 37,00%, nga Bullgaria 3,97% si dhe nga vendet tjera 12.45%.



Grafiku Nr. 9. Struktura e importit sipas shteteve-2022

### Struktura e importit të çimentos për vitin 2023- Sipas vendeve të origjinës



Grafiku Nr. 11. Struktura e importit sipas shteteve-2022

### Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2022

Kodi tarifor	Përshkrimi tarifor	Shqipëria	Maqedoni e Veriut
2523900000	Çimento të tjera hidraulike	104.60	0.00
2523290000	Çimento Portland, jo e bardhë	104.41	104.46
2523100000	Klinker prej çimentos	61.60	86.41

Tabela Nr. 9. Çmimi mesatar i furnizimit/sipas shteteve-2022

### Çmimi mesatar pa TVSH, krahasimi i çmimeve ndërmjet Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2023

Kodi tarifor	Përshkrimi tarifor	Shqipëria	Maqedoni e veriut
2523900000	Çimento të tjera hidraulike	104.97	0.00
2523290000	Çimento Portland, jo e bardhë	104.52	99.64
2523100000	Klinker prej çimentos	0.00	79.15

Tabela Nr. 10. Çmimi mesatar i furnizimit/sipas shteteve-2022

Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2022

Nr.	Shteti	Sasia totale e klinkerit (tonë)	Sasia e totale e çimentos	Perqindja e Klinkerit ne sasi totale
1	Shqipëria	310.00	381,583.34	0.08%
2	Maqedonia e Veriut	8,269	248,726.12	3.32%
	<b>Gjithsejtë importi i klinkerit</b>	<b>8,579.04</b>	<b>630,309.46</b>	

Tabela Nr. 11. Përqindja e pjesëmarrjes se Klinkerit në sasinë totale të çimentos-2022

Pjesëmarrja e klinkerit në çimento importuar nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut për vitin 2023

Nr.	Shteti	Sasia totale e klinkerit	Sasia e totale e çimentos	Perqindja e Klinkerit ne sasi totale
1	Shqipëria	0.00	441,993.71	0.00%
2	Maqedonia e Veriut	60,887.62	280,444.42	21.71%
	<b>Gjithsejtë importi i klinkerit</b>	<b>60,887.62</b>	<b>722,438.13</b>	

Tabela Nr. 12. Përqindja e pjesëmarrjes se Klinkerit në sasinë totale të çimentos-2022

Analiza e tregut për produktet e importuara të çimentos me kodin tarifor 2523900000 Çimento të tjera hidraulike, kodin tarifor 2523290000 Çimento Portland, jo e bardhë dhe kodin tarifor 2523100000, Klinker prej çimentos, është analizuar me qëllim për të parë strukturën dhe dinamikën e këtij tregu, pengesat dhe përparësitë, çmimet në vendet e rajonit dhe në Kosovë.

Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar prodhimin vendor dhe importin e çimentos në vitin 2022, nga prodhimi vendor ishin plotësuar nevojat rreth 49.15 %, (X) 50.85%. Kurse në vitin 2023, (X) rreth 49.97 % dhe pjesëmarrja e (X) ishte 52.19%.

Për vitin 2022, pjesëmarrja e (X) së bashku me (X) e çimentos në (X), (X) në Shqipëri, (X) - Maqedoni e Veriut dhe ndërmarrja (X) në Greqi, kishte mbuluar nevojat e tregut të Kosovës me çimento rreth 79.24 %, ndërmarrja e çimentos (X) nga Shqipëria kishte mbuluar diku rreth 6.66 %

të tregut, ndërmarrja e çimentos (X) nga Shqipëria kishte mbuluar nevojat e tregut e çimento rreth 6.10 %, ndërsa nga ndërmarrjet tjera të rajonit rreth 8.00%.

Ndërsa në vitin 2023, pjesëmarrja e (X) së bashku me ndërmarrjen e çimentos në (X) , ndërmarrja (X) në Shqipëri, (X), Maqedoninë e Veriut dhe ndërmarrja (X) nga Greqia, kishte mbuluar tregun e Kosovës me çimento rreth 72.62 %, ndërmarrja e çimentos (X) nga Shqipëria kishte mbuluar tregun e çimento rreth 14.63 %, ndërsa nga ndërmarrjet tjera të rajonit rreth 12.72%.

*Importi i çimentos për vitin 2022, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës*

1. Ndërmarrja (X) kishte prej 14.67 %, të importit e cila kishte blerë produkte te çimentos në e çimentos (X) në Maqedoninë e Verut dhe (X). në Shqipëri.
2. Ndërmarrja (X), kishte prej 12.00% të importit, e cila kishte blerë çimento në ndërmarrjen e çimentos (X) dhe furnizime me të vogëla nga ndërmarrjet tjera.
3. Ndërmarrja (X), kishte prej 12.78 % të importit, e cila kishte blerë çimento në ndërmarrjen e çimentos (X) në Shqipëri.
4. Ndërmarrja (X) kishte prej 12.04%, të importit e cila kishte blerë çimento në fabrikën e çimentos (X) në Shkup.
5. Ndërmarrja (X) kishte prej 7.68%, të importit e cila kishte blerë çimento në ndërmarrjen e (X) në Maqedoninë e Veriut dhe (X) Shqipëri.
6. Pjesa tjetër e importi të çimentos kishin importuar rreth 68 ndërmarrje tjera, prej 40.82% të importit.

*Importi i çimentos për vitin 2023, të ndërmarrjeve të cilat kanë përqindjen më të madhe në tregun e Kosovës*

1. Ndërmarrja (X), kishte prej 45.20 %, të importit e cila kishte blerë produkte të çimentos në ndërmarrjen e çimentos (X) në Maqedoninë e Veriut dhe (X). në Shqipëri.
2. Ndërmarrja (X) , kishte prej 29.29% të importit, e cila kishte blerë çimento në ndërmarrja (X). në Shqipëri.
3. Ndërmarrja (X), kishte prej 8.91% të importit, e cila kishte blerë çimento në ndërmarrjen e çimentos (X) në Shqipëri.
4. Pjesa tjetër e importi të çimentos kishin importuar rreth 48 ndërmarrje tjera, prej 16.61 % të importit.

Në vitin 2022, pjesëmarrja e importit të çimentos në Kosovë nga Shqipëria ishte 58.41%, nga Maqedonia e Veriut 38.07%, nga Greqia 1.34%, ndërsa nga vendet tjera 2.18%.

Në vitin 2023, pjesëmarrja e importit të çimentos në Kosovë nga Shqipëria ishte 58.32 %, nga Maqedonia e veriut 37.00% nga Bullgaria 3.97 % ndërsa nga vendet tjera 0.71 %.

Autoriteti ka analizuar importin e klinkerit, ku importi i klinkerit nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut ishte:

- Në vitin 2022 nga Shqipëria pjesëmarrja e klinkerit në importin e çimentos ishte 0.08%, ndërsa nga Maqedonia e Veriut 3.32%.
- Në vitin 2023 nga Shqipëria pjesëmarrja e klinkerit në importin e çimentos ishte prej 0.00% nga Maqedonia e veriut 21.71%.

Çmimet mesatare vjetore të furnizimit të çimentos për vitin 2022 me përshkrimin tarifor 2523900000 produkti çimento të tjera hidraulike të importuar nga Shqipëria ishin rreth 104.60 euro për tonë (pa TVSH), ndërsa nga Maqedonia e Veriut nuk kishte import me këtë përshkrim tarifor.

Çmimet mesatare vjetore të furnizimit të çimentos për vitin 2023 me përshkrimin tarifor 2523900000 produkti çimento të tjera hidraulike të importuar nga Shqipëria ishin rreth 104.97

euro për tonë (pa TVSH), ndërsa nga Maqedonia e Veriut nuk kishte import me këtë përshkrim tarifor.

Çmimet mesatare vjetore te furnizimit të çimentos me përshkrimin tarifor 25232900000 produkti çimento portland jo e bardhë në vitin 2022, ka pasur çmim mesatar pa TVSH: nga Shqipëria rreth 104.41 euro për tonë, ndërsa nga Maqedonia e Veriut rreth 104.46 euro për tonë.

Çmimet mesatare vjetore te furnizimit të çimentos me përshkrimin tarifor 25232900000 produkti çimento portland jo e bardhë në vitin 2023, ka pasur çmim mesatar pa TVSH: nga Shqipëria rreth 104.52 euro për tonë, ndërsa nga Maqedonia e Veriut rreth 99.64 euro për tonë.

Klinkeri me përshkrimin tarifor 2523100000 produkti klinker prej çimentos në vitin 2022 importuar nga Shqipëria, çmimi mesatar pa TVSH ishte rreth 61.60 euro për tonë, ndërsa nga Maqedonia e Veriut rreth 86.41, euro për tonë. Në vitin 2023 nga Maqedonia e Veriut çmimi mesatar ishte rreth 79.15 euro për tonë, nga Shqipëria nuk kishte import me këtë kod tarifor.

### 3) Çmimi mesatar i shitjes


Referuar të dhënave zyrtare në posedim, vërehet se çmimet kanë lëvizur kohë pas kohe. Por, me një tendencë të vazhdueshme të rritjes, sidomos pas muajit Gusht 2022 e deri në Janar 2023.

Lëvizjet e çmimeve në këtë periudh kanë qenë të aplikuara te të gjitha ndërmarrjet. Por, lartësia dhe çmimi për ton, ka qenë i ndryshëm, varësisht nga furnizuesit dhe çmimet e furnizimit, varësisht nga kostot operative.

Çmimet mesatare te shitjes pa TVSH 2022						
Shitja 2022	(X)	(X)	(X)	(X)	(X)	Mesatare
Janar		86.44	78.13	82.9		82.49
Shkurt		91.42	78.121	82.9	81.21	83.41
Mars		95.64	91.689	92.89	82.16	90.59
Prill		95.38	89.765	98.2	97.36	95.18
Maj		96.3	92.196	98.2	98.96	96.41
Qershor	88.25	100.92	93.09	98.81	97.36	95.69
Korrik	88.25	103.4	91.55	99.8	97.36	96.07
Gusht	95.57	113.62	95.816	107.99	97.36	102.07
Shtator	103.25	120.06	106.7	114.8	112.47	111.46
Tetor	103.25	119.53	111.52	114.8	114.29	112.68
Nentor	102.67	120.88	104.74	114.8	112.47	111.11
Dhjetor	102.67	120.85	113.25	114.8	112.47	112.81
Mesatare	97.70	105.37	95.55	101.74	100.32	99.16

Tabela Nr. 13. Çmimi mesatar i shitjes pa TVSH për çimenton e importuar-2022

## Çmimi mesatar €/tone i shitjes per vitin 2022



Grafiku Nr. 12. Çmimi mesatar i shitjes për çimenton e importuar-2022

Të dhënat e pasqyruara në grafikun nr.12, shohim se çmimi mesatar më i lartë i shitjes për vitin 2022, është 115.28 €/tone nga ndërmarrja (X). Ndërsa, mesataren më të ulët e ka (X) me 95.55 €/tone.

Çmimet mesatare te shitjes pa TVSH 2023						
Shitja 2023	X	X	X	X	X	Mesatare
<b>Janar</b>	97.17	121.32	114.37	114.8	112.27	111.99
<b>Shkurt</b>	94.69	117.97	107.135	109	110.21	107.80
<b>Mars</b>	94.69	116.5	106.4	109	112.21	107.76
<b>Prill</b>	94.69	116.13	107.82	109	110.2	107.57
<b>Maj</b>	95.72	116.17	107.23	109	108.37	107.30
<b>Qershor</b>	95.72	116.25	105.96	109	110	107.39
<b>Korrik</b>	94.69	114.56	104.93	109	110.21	106.68
<b>Gusht</b>	94.69	113.09	105.42	109	110.7	106.58
<b>Shtator</b>	106.42	113.28	106.68	109	110	109.08
<b>Tetor</b>	106.42	112.52	106.11	109	109.14	108.64
<b>Nentor</b>	106.42	112.84	106.94	109	109.86	109.01
<b>Dhjetor</b>	94.79	112.76	106.66	109	110	106.64
<b>Mesatare</b>	98.01	115.28	107.14	109.48	110.26	108.04


Tabela Nr. 14. Çmimi mesatar i shitjes se çimentos se importuar-2023



Gjatë analizës së çmimeve të shitjes së çimentos, vërejmë se çmimi më i ultë në vitin 2022, ishte 81.21 €/tone, në muajt Shkurt, nga ndërmarrja Jehona.

Kurse, çmimi më i ultë në vitin 2023, ishte 94.69 €/tone, në muajt Shkurt, Mars, Korrik e Gusht, nga ndërmarrja (X).

Ndërsa çmimi më i lartë sipas viteve ishte: në vitin 2022, 120.88 €/tone (X-Nentor) dhe 117.97 €/tone (X-Shkurt 2022).



Grafiku Nr. 13. Çmimi mesatar pa TVSH-2023


Të dhënat e pasqyruara në grafikun nr.13, shohim se çmimi mesatar më i lartë i shitjes për vitin 2023, është 115.28 €/tone nga ndërmarrja (X). Ndërsa, mesataren më të ulët e ka (X) me 98.01 €/tone.

Autoriteti gjatë analizës ka vërejtur se: ndërmarrjet e lartë cekura të cilat prodhojnë, blejnë dhe shesin çimento në Kosovë rreth 80% e këtyre ndërmarrjeve kanë kontrata me klientët, në kontrata është e potencuar në rast se ka ngritje apo ulje të çmimeve shitësi njofton blerësin për ndryshimin e çmimeve.


Lidhur me çmimet e çimentos së prodhuar në Kosovë, vërejmë lëvizje të çmimeve që nga muaji Janar 2022 e deri në muajin shkurt 2023. Nga aty e tutje çmimi është standard.

Muaj	2022	2023
Janar	55.8	112.1
Shkurt	66.4	110.9
Mars	74.6	110.9
Prill	80.3	110.9
Maj	80.4	110.9
Qershor	80.3	110.9
Korrik	80.2	110.9
Gusht	89	110.9
Shtator	113.1	110.9
Tetor	113.2	110.9
Nentor	112.3	110.9
Dhjetor	112.7	110.9
<b>Mesatare</b>	<b>88.19</b>	<b>111.00</b>

Tabela Nr. 15. Çmimi i shitjës së çimentos së (X) në Kosovë



Grafiku Nr. 14. Çmimi mesatar i shitjës së çimentos së (X) -2022




Grafiku Nr. 15. Çmimi mesatar i shitjes se çimentos se (X)-2023

Siç mund të shihet nga diagramet dhe tabelat me lartë, vërehet një rritje e çmimit të çimentos se (X) në Kosovë. Ndërsa, nga muaj shkurt 2023, çmimi ka mbetur standard deri në dhjetor të po këtij viti.

Duke qenë se (X), ka ndikimin më të madh në treg, në vazhdim është pasqyruar krahasimi i çmimit të shitjes se çimentos se (X) në Kosovë ne raport me çmimin më të ulët dhe me të lartë në secilin muaj, për shitjen e çimentos se (X).

Shitja 2022	X	X	X
<b>Janar</b>	55.8	78.13	86.44
<b>Shkurt</b>	66.4	78.12	91.42
<b>Mars</b>	74.6	82.16	95.64
<b>Prill</b>	80.3	89.76	98.2
<b>Maj</b>	80.4	92.19	98.96
<b>Qershor</b>	80.3	93.09	100.92
<b>Korrik</b>	80.2	91.55	103.4
<b>Gusht</b>	89	95.81	113.62
<b>Shtator</b>	113.1	106.7	120.06
<b>Tetor</b>	113.2	111.52	119.53
<b>Nentor</b>	112.3	104.74	120.88
<b>Dhjetor</b>	112.7	112.47	120.85

Tabela 16. Krahasimi çmimeve mes çimentos se (X) dhe asaj të (X)




Grafiku Nr. 16. Krahasimi i çmimit të shitjes mes çimentos se X dhe asaj të X

Siç shihet nga të dhënat në diagramin nr. 16, shohim dallime në çmime. Deri në muajin Gusht 2022, kemi çmimin më të ultë atë të çimentos se (X) në Kosovë. Pastaj, çmimet e (X) në raste të caktuara ishin më të ulëta (gjithnjë duke mos përfshirë çimenton e shitur nga (X), përveç asaj të (X) në Kosovë).

Shitja 2023	X	X	X	X	X	Mesatare
<b>Janar</b>	97.17	121.32	114.37	114.8	112.27	111.99
<b>Shkurt</b>	94.69	117.97	107.135	109	110.21	107.80
<b>Mars</b>	94.69	116.5	106.4	109	112.21	107.76
<b>Prill</b>	94.69	116.13	107.82	109	110.2	107.57
<b>Maj</b>	95.72	116.17	107.23	109	108.37	107.30
<b>Qershor</b>	95.72	116.25	105.96	109	110	107.39
<b>Korrik</b>	94.69	114.56	104.93	109	110.21	106.68
<b>Gusht</b>	94.69	113.09	105.42	109	110.7	106.58
<b>Shtator</b>	106.42	113.28	106.68	109	110	109.08
<b>Tetor</b>	106.42	112.52	106.11	109	109.14	108.64
<b>Nentor</b>	106.42	112.84	106.94	109	109.86	109.01
<b>Dhjetor</b>	94.79	112.76	106.66	109	110	106.64
<b>Mesatare</b>	98.01	115.28	107.14	109.48	110.26	108.04

Tabela 17. Krahasimi çmimeve mes çimentos se X dhe asaj të X -2023



Grafiku Nr. 17. Krahasimi i çmimit të shitjes mes çimentos se X në Kosovë dhe asaj të X-2023

Siç shihet nga të dhënat në diagramin nr. 17, shohim dallime në çmime. Ku në asnjë muaj çmimi i shitjes së çimentos se (X) nuk ishte as më i ulëti e as më i larti se çimento e shitur nga ndërmarrjet tjera (pra jo X).

#### 4) Çmimi mesatar i blerjes sipas muajve


Referuar të dhënave në disponim, rezulton se edhe çmimi i furnizimit për ton, ka variruar në varësi nga muajt dhe nga vendi i furnizimit

<i>Importi 2022</i>	X	X	X	X	X	Mesatare
<i>Janar</i>			77.69	83.46	85.04	82.38
<i>Shkurt</i>	128.61	131.13	79.05	83.4	82.43	100.92
<i>Mars</i>	126.95	85.71	73.77	93.72	94.28	94.88
<i>Prill</i>	112.47	92.23	80.74	98.62	97.01	96.21
<i>Maj</i>	109.75	89.42	94.59	98.7	97.65	98.02
<i>Qershor</i>	97.45	90.43	94.91	99.28	96.79	95.77
<i>Korrik</i>	92.42	96.78	94.19	100.3	96.87	96.11
<i>Gusht</i>	98.63	98.08	92.27	106.52	103.88	99.87
<i>Shtator</i>	109.72	103.56	109.82	115.3	111.42	109.96
<i>Tetor</i>	107.36	105.26	110.43	115.3	111.94	110.05
<i>Nentor</i>	106.07	110.07	110.17	115.3	111.41	110.60
<i>Dhjetor</i>	109.69	114.86	109.51	115.3	111.3	112.13
<i>Mesatare</i>	102.38	97.22	96.70	105.48	101.88	100.55

Tabela 18. Çmimi mesatar i furnizimit-2022

Siç shihet në tabelën nr.18, çmimi më i ultë i importuar i çimentos në vitin 2022, ishte 73.77 €/ton (ndërmarrja X në muajin Mars), nga blerjet e të gjitha llojeve të çimentos. Ndërsa, çmimi më i lartë ishte 131.13 €/ton (ndërmarrja X në muajin Shkurt).

## Çmimi mesatar i shitjes sipas muajve-2022




	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Mesatare	82.49	83.41	90.59	95.18	96.41	95.69	96.07	102.07	111.46	112.68	111.11	112.81

Grafiku Nr. 18. Çmimi mesatar i shitjes sipas muajve-2022

<b>Importi 2023</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>X</b>	<b>Mesatare</b>
Janar	104	106.73	110.87	107.20
Shkurt	103.14		106.25	104.70
Mars	103.98	104.17	106.21	104.79
Prill	104.17	112.7	106.67	107.85
Maj	104.33	103.79	106.13	104.75
Qershor	104.35	101.11	105.45	103.64
Korrik	102.36	104.28	103.43	103.36
Gusht	100.5	106.88	103.12	103.50
Shtator	99.53	112.75	105.08	105.79
Tetor	99.94	104.06	105.67	103.22
Nentor	100.86	101.01	105.68	102.52
Dhjetor	98.61	103.58	105.17	102.45
Mesatare	101.94	105.83	105.27	104.35

Tabela 19. Çmimi mesatar i furnizimit-2023

Ndërsa në vitin 2023, siç shihet edhe në tabelën nr.19, çmimi më i ultë i furnizimit me çimento, ishte 101.01 €/ton (ndërmarrja X në muajin Nëntor), nga blerjet e të gjitha llojeve të çimentos. Ndërsa, çmimi më i lartë ishte 113.41 €/ton (ndërmarrja X në muajin Maj).



Grafiku Nr. 19. Çmimi mesatar i shitjes sipas muajve-2022

Nëse analizojmë të dy vitet, vërehet rritja e çmimit të çimentos në përgjithësi. Por, më shumë vërehet pas muajit shtator 2022.



### III. Konkluzion

Autoriteti gjatë analizës së tregut të çimentos në Kosovë konsideron se: tregu është i koncentruar në **katër** Ndërmarrjet (X) të cilat janë: prodhuesi vendor (X) në Kosovë, (X) në Shqipëri, (X) në Maqedoninë e Veriut, dhe ndërmarrja (X) në Greqi, të cilat e mbulojnë mbi **76.00%** të tregut relevant në Kosovë, kurse pjesa tjetër importohet nga fabrika e (X) , nga (X), (X), etj.

Autoriteti konsideron se: tek tregu me përqendrim të lartë, në të ardhmen nuk përjashtohet mundësia e keqpërdorimit të pozitës dominuese, marrëveshjeve të ndaluara apo praktikave të bashkërenduara, ndërmjet fabrikave prodhuese të çimentos në rajone, andaj **Autoriteti në vazhdimësi do të monitorojë tregun e çimentos në Kosovë.**

Në bazë të të dhënave në dispozicion, sipas LMK-së, ndërmarrja (X), ka pozitë dominuese për të dy vitet. Por, referuar të dhënave, nuk vërehet ndonjë veprim i cili ka mundur të konsiderohet si shtrembërim i pozitës dominuese në tregun përkatës.

Çmimi më i ultë i importuar i çimentos në vitin **2022**, ishte **73.77** €/ton (ndërmarrja X në muajin Mars), nga blerjet e të gjitha llojeve të çimentos.

Çmimi më i lartë ishte **131.13** €/ton (ndërmarrja X në muajin Shkurt).

Ndërsa në vitin **2023**, çmimi më i ultë i furnizimit me çimento, ishte **98.61** €/ton (ndërmarrja X në muajin Dhjetor), nga blerjet e të gjitha llojeve të çimentos.

Ndërsa, çmimi më i lartë ishte **112.75** €/ton (ndërmarrja X në muajin Shtator).

Nëse analizojmë të dy vitet, vërehet rritja e çmimit të çimentos në përgjithësi. Por, më shumë vërehet pas muajit shtator 2022.

Konkurrenca në këtë treg është e përqendruar në shumë ndërmarrjet importuese, të cilat janë përafërsisht 62 ndërmarrje. Ndërmarrja X nuk ka kapacitet t'i mbulojë nevojat e çimentos në Kosovë për faktin se kapaciteti i saj është i limituar, **pasi që e njëjta i mbulon nevojat në tregun e Kosovës rreth 50%.**